

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çmimet në rritje, Ibrahimaj: Po monitorojmë karburantet dhe konsumin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/mimet-ne-rritje-ibrahimaj-po-monitorojme-karburantet-dhe-konsumin-i587345
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 19:13:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 19:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ee2c4caef6214ca47cc30be0a66209383276ef83e68b911fed6f0df50e66d46
TEKSTI	9bd5df39cc83b1003f59e7e0e714926c37bee2167b8834ca20dae55680a1fb52
PAMJA	89a8ffeac2de21f20e2b44d266ab013b4b4dbc5d8683208c389cbeedca42ee2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab3c95a8bcd62ab9df763794ba667815bab44bda7eedf1bf44993460cadcf5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e177be5550b4bd5f7d602f1900530a2156b51a950cd15b25e46c1bef83200b8c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab3c95a8bcd62ab9df763794ba667815bab44bda7eedf1bf44993460cadcf5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Çmimet në rritje, Ibrahimaj: Po monitorojmë karburantet dhe konsuminNetanyahu urdheron intensifikimin e operacioneve ushtarake në Bregun PerëndimorReal Madrid

Çmimet në rritje, Ibrahimaj: Po monitorojmë karburantet dhe konsumin

TemA

20 Shtator 2026, 21:10Ekonomia TEMA



Rritja e çmimeve po rikthen në vëmendje nevojën për masa mbështetëse për familjet dhe shtresat në nevojë. Rikthimi nga qeveria i Bordit të Transparencës për karburantet, në një kohë kur çmimi i naftës ka arritur në 229 lekë për litër, është një tjetër tregues i presioneve që po shfaqen në treg.

Por shqetësimi nuk lidhet vetëm me karburantet, pasi rritja e kostove mund të reflektohet edhe në produkte dhe shërbime të tjera, duke shtuar barrën mbi buxhetet familjare.

Ndërsa vende të tjera të rajonit kanë ndërmarrë masa për të frenuar efektet e rritjes së çmimeve, si ulja e çmimeve në Greqi apo reduktimi i akcizës për naftën në Malin e Zi, në Shqipëri mbetet e hapur pyetja nëse do të ketë një paketë të posaçme mbështetëse për kategoritë në nevojë. E pyetur në emisionin "E-Zone" nga gazetarja Rajmonda Lajthia, ministrja e Ekonomisë, Delina Ibrahimaj, tha se qeveria po monitoron situatën dhe se ndërhyrjet do të varen nga ecuria e çmimeve.

"Unë mendoj që ne si politikë e përgjithshme duhet të përqendrohemi në rritjen e nivelit të të ardhurave dhe në reduktimin e çmimeve. Pra, duhet të ndërhyjmë me mekanizma të qëndrueshëm dhe kur ka dukuri të qëndrueshme. Inflacioni në këto vitet e fundit ka qenë i kontrolluar. Pra, nuk jemi në kushtet që kemi një inflacion të rritur në mënyrë të pakontrolluar për shkak të një efekti të jashtëm, siç kemi qenë për shembull para tre-katër viteve, kur kishim krizën energjetike që të gjitha çmimet u ndikuan jashtëzakonisht shumë dhe ne na u desh të ndërhynim disa herë në subvencione për kategoritë në nevojë, me qëllim që të suportonim atë rritje të çmimeve, e cila e dinim që do të ishte e përkohshme."

Ibrahimaj tha se gjatë këtij viti është konstatuar një rritje e çmimeve të karburanteve, por sipas saj kjo rritje nuk është transmetuar në të njëjtin nivel të çmimit e produkteve ushqimore. *"Ne që kur filloi kriza në Lindjen e Mesme kemi bërë një monitorim të vazhdueshëm të çmimeve të konsumit dhe të çmimeve të karburanteve, me qëllim për të kuptuar tendencat dhe për të kapur tendencat në kohë"*, deklaroi ministrja.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Energjia fotovoltaike, shtyllë e zhvillimit tonë ekonomik?](#)

18:50 Ekonomia / 2 komente

[SEPA nxit remitancat, BSH: Ulja e kostove ka shtuar dërgesat e emigrantëve](#)

15:10 Ekonomia / 1 koment

Hyn në fuqi manuali i ri doganor për automjetet, fatura mbetet primare, kilometrazhi përfshihet si kriter vlerësimi, ja çfarë ndryshon në zhdoganimin e makinave

22:05 Ekonomia / 2 komente

A po i afrohet paga vlerës reale të punës, tregu që po rishkruan peshën e diplomës, aftësisë dhe përvojës

20:05 Ekonomia / 1 koment



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.